

# Buletin informativ

Dhjetor 2020



Ekspertët fiskal në Mazars, sjellin pranë jush buletin informativ të rradhës si një përmbledhje e ndryshimeve dhe shtesave më të fundit ligjore të publikuara në vendin tonë.

## ❖ **Ndryshon paga minimale në shkallë vendi**

Që nga 1 Janari 2021, paga bazë minimale mujore, për punonjësit, në shkallë vendi, do të rritet nga 26,000 lekë në 30,000 lekë.

*Burimi: Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1025, datë 16.12.2020 "Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi", Fletore zyrtare nr.223 datë 21.12.2020.*

## ❖ **Kategori të reja furnizimesh me TVSH 6%**

Furnizimet e mëposhtme i shtohen listës së furnizimeve me shkallë të reduktuar të Tatimit mbi Vlerën e Shtuar:

- Shërbimet e punimeve të ndërtimit për investimet shtetërore të klubeve sportive/federative sportive;

- Investimet e subjekteve private në infrastrukturën sportive, të përcaktuar në legjislacionin e fushës për sportin.

*Burimi: Ligj nr. 123/2020, datë 15.10.2020, Për një shtesë në ligjin nr. 92/2014, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, Fletore zyrtare nr.197 datë 12.11.2020.*

#### ❖ Të rejat rreth procesit të fiskalizimit

Që nga 1 Janari 2021, të gjithë tatimpaguesit që kryejnë transaksione shitje me entet publike do të jenë të detyruar të lëshojnë faturë elektronike për mallrat apo shërbimet e ofruara.

Po kështu, dhe entet publike, pas kësaj date, për mallrat apo shërbimet e blera nga tatimpaguesit do të pranojnë vetëm faturën elektronike, e cila do të jetë dokumentacion i vetëm i vlefshëm tatimor për furnizimet e marra.

Lista zyrtare e subjekteve që konsiderohen ente publike gjendet në linkun:

<https://www.tatime.gov.al/d/8/45/0/1476/lista-e-subjekteve-sipas-formes-ligjore-ent-publik-per-tatimpaguesit-qe-do-te-kryejne-procesin-e-fiskalizimit>

## KONTAKT

### MAZARS ALBANIA & KOSOVO

Për më shumë detaje për çështjet e mësipërme apo të tjera në aspektin fiskal, ju lutem drejtohuni:

#### Teit GJINI

Managing Partner  
teit.gjini@mazars.al

#### Erinda XHAFERRAJ

Head of Tax Advisory Services  
erinda.xhaferraj@mazars.al

#### Adresa

Rr. Emin Duraku, Pall. Binjaket, Nr.5,  
Tiranë, Shqipëri

Tel: +355 4 2222 889  
E-mail: info@mazars.al